



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 6 dhe 7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neni 11 dhe 12 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 9,17,20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008 si dhe Shkresës së Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal Nr.0204-1715/2 të dt.10.12.2015, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 29. 01. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, miratojë këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 20 vitesh personave fizik dhe juridik paluajtshmëria që gjendet në zonën kadastrale në Babush i Muhaxherëve me sipërfaqe prej 0.50,00 ha pjesë e ngastrës kadastrale P-71409059-00562-1 në vendin e quajtur "Balkan" me kulturë kullosë e kl.V-të me sipërfaqe të përgjithshme prej 21.16,66 ha e evidentuar në Certifikatën nr.1488/2015 ZK Babush i Muhaxherëve, Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Anulohet Vendimi i Kuvendit Komunal Lipjan 15Nr.464-57885/2015 dt.25.11.2015 për vazhdimin e vendimit të KK Lipjan 1nr.465-168 të dt.13.04.2004 për shfrytëzim të sipërfaqes së paluajtshmërisë.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së komunës është ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 4

Sipas nenit 1 të këtij vendimi prona ipet në shfrytëzim në afat prej 20 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal 15 Nr.404-13205 të dt.31.03.2014, dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Prokurimit dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

15Nr. 464-5839

Lipjan, më 01. 02. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajruni

